



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 208/2013

6 janar 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 1094, datë 26.12.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 660, datë 12.9.2007 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve njësive të qeverisjes vendore”, të ndryshuar.....	9219
Udhëzim i MTI nr. 5, datë 19.12.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 994, datë 12.3.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e autoshkollave”, të ndryshuar.....	9221
Urdhër i MZHETS nr. 150, datë 19.12.2013	Për delegim kompetence.....	9221
Vendim i GJK nr. 54, datë 23.12.2013	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën, të vendimeve: nr. 114, datë 21.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; nr. 58, datë 6.6.2005 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr. 00-2011-879 (122), datë 5.10.2011 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	9222
Vendim i GJK nr. 55, datë 23.12.2013	Me objekt shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr. 260, datë 14.6.2010 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 142, datë 31.1.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	9225
Vendim i KQZ nr. 849, datë 23.12.2013	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Demokratike në qarkun Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	9228

VENDIM
Nr. 1094, datë 26.12.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 660, DATË 12.9.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 1.II, shkronja “a”, 10, pika 3.I, shkronjat “a” e “b” dhe 72, pika 5.I, shkronjat “a” e “b” të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, dhe të neneve 3, shkronja “a”, 4, 6, shkronja “a”, 7, 8 e 16, pika 1 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr. 1 “Lista e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, aksionet e të cilave do të transferohen në njësitë e qeverisjes vendore (NJQV)”, nr. 28, Ujësjellës-Kanalizime Malësia e Madhe sh.a. dhe nr. 31 Ujësjellësi Shkodër, Fshat, sh.a., ndryshohen sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Nr.	Emërtimi i shoqërisë	Lloji	Referenca e miratimit të listave të inventarit		Nr. i pasurisë	Njësitë e qeverisjes vendore		
			Lista nr.	VKM nr., datë		Emri i njësisë	Nr. i popullatës	% e aksioneve për çdo NJQV
31	Ujësjellësi Shkodër-Fshat	sh.a.	4	366, 05.06.2003	68,770	Komunës Berdicë	9.101	6.05
						Komunës Velipojë	8.403	5.60
						Komunës Hajmel	6.319	4.21
						Komunës Gur i Zi	11.591	7.72
						Komunës Ana e Malit	5.847	3.89
						Komunës Shalë	5.044	3.36
						Komunës Rrethinat	22.465	14.95
						Komunës Shllak	1.834	1.22
			251, 24.04.2003	54.418	Komunës Postribe	12.000	7.99	
					Komunës Shoshë	2.000	1.22	
					Komunës Vig-Mnelë	2.592	1.73	
					Komunës Dajç	8.800	5.86	
					Bashkisë Koplík	11.001	7.32	
					Komunës Shkrel	5.998	3.99	
					Komunës Qendër Koplík	5.881	3.91	
					Komunës Kastrat	12.104	8.06	
Komunës Kelmend	6.669	4.43						
Komunës Gruemirë	12.765	8.49						

Lista e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, aksionet e të cilave do të transferohen në njësitë e qeverisjes vendore (NJQV)



UDHËZIM
Nr. 5, datë 19.12.2013

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 994, DATË 12.3.2003 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTOSHKOLLAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, neni 102 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 119 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 313 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 994, datë 12.3.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e autoshkollave”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Neni 16, paragrafi i tretë, ndryshon si vijon:

“Personat e interesuar fitojnë provën e kontrollit të njohurive teorike për lejedrejtimi mjeti rrugor, kur u përgjigjen në mënyrë korrekte 33 pyetjeve ose më shumë, nga 40 pyetje që përmban testi.

Testet hartohen nga DPSHTRR-ja, në përputhje me nenin 311, pika 7 të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

URDHËR
Nr. 150, datë 19.12.2013

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), si dhe të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 21.5.2003 “Për pozicionin, detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministri”,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në proceset gjyqësore, të lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë Ministrinë.

2. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në proceset gjyqësore, sipas pikës 1 të këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të caktuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit.

3. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 54, datë 23.12.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 24.10.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 41 Akti, që i përket:

KËRKUES: Rrapo Muçi

SUBJEKTI I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, i vendimeve: nr. 114, datë 21.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; nr. 58, datë 6.6.2005 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr. 00-2011-879 (122), datë 5.10.2011 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të mbrojtësit të kërkuarit, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 114, datë 21.10.2003, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprës penale të “rrëmbimit të personit”, parashikuar nga neni 109/1 i Kodit Penal (KP) dhe, në aplikim të nenit 25 të KP-së, e ka dënuar me 18 vjet burgim. Kërkuari ka qenë në mungesë, i përfaqësuar nga avokati i caktuar nga familjarët.

2. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 35, datë 8.4.2004, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 2, datë 12.1.2005, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 35, datë 8.4.2004 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim, pranë po asaj gjykate, me trup tjetër gjykuar.

4. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 58, datë 6.6.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 114, datë 21.10.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 455, datë 14.7.2006, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari. Në të tria shkallët e juridiksionit të zakonshëm kërkuari është mbrojtur nga avokati i caktuar nga familjarët.

6. Kërkuari i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për parregullsi të procesit gjyqësor të zhvilluar ndaj tij, kërkesë e cila nuk është kaluar për shqyrtim në seancë plenare për arsye të paraqitjes së saj jashtë afatit (*shih vendimin e moskalimit nr. 141, datë 26.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).



7. Në datën 12.6.2009, kërkuesi është ndaluar nga policia për efekt të ekzekutimit të vendimit penal të formës së prerë. Ai ka bërë kërkesë për rivendosje në afat për të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, të cilën, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 144, datë 31.7.2009, e ka pranuar.

8. Kërkuesi ka ushtruar rekurs ndaj vendimit nr. 58, datë 6.6.2005 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka vlerësuar se një rekurs i tillë ndaj të njëjtit vendim gjyqësor është marrë njëherë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë dhe përbën gjë të gjykuar (*res judicata*), ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, me vendimin nr. 00-2011-879, datë 5.10.2011.

9. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës, duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, ai ka parashtruar se është cenuar:

9.1 E drejta për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë në gjykim, pasi ai është gjykuar në mungesë, duke mos pasur dijeni për zhvillimin e procesit penal kundër tij;

9.2 E drejta për një mbrojtje efektive për shkak se avokati i caktuar nga familjarët ka mbrojtur të gjithë të pandehurit në kushtet e papajtushmërisë së interesave midis tyre dhe në kundërshtim me nenin 54/1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP);

9.3 Parimi i sigurisë juridike pasi Gjykata e Lartë, në arsyetimin e saj, i është referuar një vendimi unifikues të Kolegjeve të Bashkuara, i cili është në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), për sa i përket gjykimit në mungesë;

9.4 E drejta për një proces të rregullt ligjor, lidhur me marrjen dhe përdorimin e provave gjatë procesit gjyqësor, të cilat janë marrë pa respektuar dispozitat procedurale penale që rregullojnë sigurimin e provës së të dëmtuarit, deklaratimet e të bashkëpandehurve dhe paraqitjen për njohje.

10. **Subjekti i interesuar**, Prokuroria e Përgjithshme, në parashtrimet drejtuar Gjykatës, ka paraqitur këto prapësime:

10.1 Pretendimi i kërkuesit, në drejtim të cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar, është i pabazuar pasi gjykatat kanë bërë të gjitha përpjekjet ligjore për t'i dhënë kërkuesit një njoftim efektiv, si dhe për marrjen e masave për të siguruar praninë e tij në gjykim;

10.2 Sipas kuadrit kushtetues dhe ligjor, në kohën e zhvillimit të procesit gjyqësor ndaj kërkuesit, realizimi i mbrojtjes së të pandehurit, në të gjitha shkallët e gjyqësorit, nga avokati i caktuar nga familja e tij konsiderohej si pjesë e procesit të rregullt ligjor. Avokati i caktuar nga familjarët i ka mbrojtur interesat e kërkuesit në të gjitha shkallët e juridiksionit të zakonshëm, ndaj pretendimi i kërkuesit për cenim të së drejtës për një mbrojtje efektive është i pambështetur;

10.3 Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata e Lartë e ka respektuar parimin e sigurisë juridike në vendimmarrjen e saj, parim të cilin e ka vlerësuar në aspektin e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe të parimit të gjësë së gjykuar (*res judicata*);

10.4 Kërkuesi nuk mund të ngrejë pretendime që lidhen me procesin gjyqësor të themelit, duke përfshirë edhe pretendimin për marrjen e provave, për arsye se ai është jashtë afatit ligjor 2-vjeçar për paraqitjen e tyre në Gjykatën Kushtetuese.

II

Vlerësimi i Gjykatës

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Në rastin konkret, për shkak se argumentet e paraqitura nga kërkuesi lidhen si me procesin e themelit, ashtu dhe me atë të rivendosjes në afat, Gjykata e sheh të arsyeshme të vlerësojë çështjen e legjitimitimit veçmas për të dy proceset.

i) Për procesin e themelit

12. Subjekti i interesuar ka parashtruar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* t'i

drejtohet Gjykatës, për sa u përket pretendimeve që lidhen me procesin gjyqësor të themelit, pasi është jashtë afatit dyvjeçar të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

13. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme, Gjykata ka ritheksuar se çështja e legjitimitetit të kërkuarit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individit, në kuptim të neneve 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “g” dhe pika 2 të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike.

14. Në bazë të nenit 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, “*kërkesa e individit për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqitet jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes (...)*”. Gjykata, duke iu referuar jurisprudencës së saj dhe asaj GJEDNJ-së, ka pranuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 17, datë 19.6.2009; nr. 26, datë 15.12.2008; nr. 19, datë 23.12.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në praktikën e Gjykatës, në rastet kur kërkuari është gjykuar në mungesë (*in absentia*), afati dyvjeçar për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë fillon në momentin kur kërkuari merr dijeni për vendimin e formës së prerë të dhënë ndaj tij (*shih vendimin nr. 9, datë 29.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo praktikë e Gjykatës është pranuar edhe nga GJEDNJ-ja në çështjen *Shkalla kundër Shqipërisë, datë 10.5.2011, §53*.

16. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se, pretendimet e kërkuarit i referohen kryesisht shkeljeve të pretenduara gjatë gjykimit të themelit të zhvilluar në tri shkallët e juridiksionit të zakonshëm. Ky proces gjyqësor rezultoi të ketë përfunduar në datën 14.7.2006, me një vendim penal të formës së prerë.

17. Mbi bazën e materialeve të administruara në dosje, Gjykata konstaton se kërkuari është vënë në dijeni të këtij vendimi penal të formës së prerë në datën 12.6.2009, kur është ndaluar nga policia për efekt të ekzekutimit të tij. Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është depozituar në datën 13.5.2013, pra jashtë afatit 2-vjeçar që merret parasysh në funksion të inicimit të gjykimit kushtetues, duke filluar nga momenti kur kërkuari ka ardhur në dijeni të dënimit të tij *in absentia*.

18. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuari nuk legjitimohet *ratione temporis*, për sa u përket pretendimeve të ngritura prej tij, që lidhen me gjykimin e themelit.

ii) Për procesin e rivendosjes në afat

19. Gjykata konstaton se, për sa i përket procesit të rivendosjes në afat, kërkuari legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe nenit 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Vendimi i fundit i dhënë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, për këtë proces, mban datën 5.10.2011, dhe kërkesa e paraqitur pranë kësaj gjykate mban datën 13.5.2013, çka provon respektimin nga kërkuari të afatit 2-vjeçar të parashikuar nga ligji i sipërpërmendur.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

20. Kërkuari ka pretenduar, gjithashtu, cenim të parimit të sigurisë juridike, pasi Gjykata e Lartë në arsyetimin e saj i është referuar një vendimi unifikues të Kolegjeve të Bashkuara (*vendimi unifikues nr. 1, datë 20.1.2011*), i cili është në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, për sa i përket gjykimit në mungesë. Sipas kërkuarit, Gjykata e Lartë, në shqyrtimin e çështjeve identike me çështjen konkrete, është bazuar te qëndrimi unifikues i vendimit të sipërcituar në disa raste, dhe nuk e ka aplikuar atë në rastet e tjera.

21. Gjykata ka ritheksuar se interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, Kushtetuta i ka dhënë



Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme (*shih vendimin nr. 6, datë 17.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Referimi në vendime unifikuese, si pjesë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, hyn në vlerësimin diskrecional të gjyqtarit të zakonshëm gjatë gjykimit të çështjeve konkrete.

22. Për sa më lart, në çështjen në shqyrtim, Gjykata vlerëson se argumentet e parashtruara nga kërkuesi, në mbështetje të pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, nuk janë ngritur në nivel kushtetues, ndaj, rrjedhimisht, janë të pabazuara.

23. Si përfundim, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis* t'i drejtohet Gjykatës për pretendimet e ngritura prej tij në lidhje me procesin gjyqësor të themelit, ndërsa, për sa i përket procesit gjyqësor të rivendosjes në afat, çmon se pretendimet e kërkuesit, në drejtim të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë, dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 55, datë 23.12.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 26.9.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 31 Akti, që i përket:

KËRKUES: Islam Prodani

SUBJEKTI I INTERESUAR: Albert Disho

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr. 260, datë 14.6.2010 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 142, datë 31.1.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatos Lulo, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme me nr. 19/59, me sipërfaqe 24 m², “ndërtesë 1-kat., në lagjen “5 Maj”, Elbasan”, subjekti i interesuar e ka fituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr.-179 -Rep., nr. -583-Kol. Subjekti i interesuar, duke pretenduar për posedim të paligjshëm të pronës nga ana e kërkuetit Islam Prodani, i është drejtuar gjykatës me padi, me objekt *“Detyrimin e të paditurit Islam Prodani që të lirojë dhe dorëzojë lokalin e ndodhur në lagjen “5 Maj” Elbasan. Detyrimin e të paditurit Islam Prodani të paguajë shpërblimin për përdorimin e lokalit, në shumën prej 90 000 lekësh”.*

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 1389, datë 21.5.2008, ka vendosur: *“Detyrimin e të paditurit Islam Prodani që t’i lirojë dhe t’i dorëzojë paditësit Albert Disho lokalin një kat, me sipërfaqe prej 24 m², të ndodhur në lagjen “5 Maj” të qytetit Elbasan. Detyrimin e të paditurit Islam Prodani që t’i paguajë paditësit Albert Disho një shpërblim për përdorimin e lokalit, në shumën prej 70 000 lekësh”.*

3. Gjykata e Apelit Durrës, pas ankimit të kërkuetit Islam Prodani, me vendimin nr. 10-2010-536 (260), datë 14.6.2010, ka vendosur: *“Mospranimin e ankimit të bërë ndaj vendimit nr. 1398, datë 21.5.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”.*

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pas rekursit të bërë nga kërkueti Islam Prodani, me vendimin nr. 00-2013-142, datë 31.1.2013, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga i padituri Islam Prodani kundër vendimit nr. 10-2010-536 (260), datë 14.6.2010 të Gjykatës së Apelit Durrës.”*

II

5. **Kërkueti Islam Prodani** ka parashtruar shkaqe për shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar për shkelje të së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42/1 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

a) Vendimi i Gjykatës së Apelit është marrë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, me dispozitat e kreut I “Mjetet dhe afatet e ankimit” dhe të kreut II “Paraqitja e ankimit dhe gjykimi në apel”, për rrjedhojë, mospranimi i ankimit për mungesë legjitimitimi në ankim, nga ana e Gjykatës së Apelit, ka cenuar të drejtën e aksesit efektiv në gjykatë, si një element thelbësor i procesit të rregullt ligjor;

b) Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, nuk i ka dhënë mundësi palës që të mbrojë interesat përkatëse në çështjen në gjykim.

6. Gjithashtu, kërkueti, edhe pse nuk ka pretenduar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, në kërkesën e tij ka argumentuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka shkelur rregullat procedurale, duke disponuar në kundërshtim me nenin 302 të KPC-së dhe duke i mohuar kërkuetit të drejtën për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare. Për rrjedhojë, në arsyetimin e vendimit nuk i është dhënë përgjigje këtyre pretendimeve, si dhe nuk është respektuar parimi i kontradiktoritetit gjatë administrimit dhe vlerësimit të provave nga ana e gjykatës.

III

7. Gjykata thekson se cenimi i së drejtës së aksesit të kërkuetit lidhet me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, konkretisht, me aspektin e detyrimit të Gjykatës së



Apelit dhe Gjykatës së Lartë për respektimin e standardeve. Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet vetëm lidhur me pretendimin për cenim të procesit të rregullt ligjor nga Gjykata e Apelit dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Pretendimet e tjera në lidhje me zhvillimin e gjykimit në shkallë të parë, janë haptazi të pambështetura dhe nuk janë objekt i kërkesës së paraqitur përpara Gjykatës.

A. Për cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Lartë

8. Në lidhje me gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit Durrës, kërkuesi pretendon se gjykata ka keqinterpretuar nenin 450/ç të KPC-së, duke ngatërruar konceptin e legjitimitetit me përfaqësimin në gjykatë, pasi çështja e ekzistencës ose jo të legjitimitetit nuk ngrihet për avokatin që ka formuluar ankimin, por thjesht dhe vetëm mbi personin në emër dhe për interes të të cilit bëhet ankimi. Edhe pse ankimi është bërë nga avokati L.M., për zënie afati, ai është bërë në emër dhe për llogari të kërkuesit Islam Prodani, përfaqësuesit e të cilit, me pjesëmarrjen e tyre në gjykimin e çështjes në apel, kanë deklaruar se janë dakord me ankimin dhe e pranojnë atë.

9. Gjykata është shprehur se në një shoqëri demokratike, e drejta për administrim të mirë të drejtësisë zë një vend të dallueshëm dhe asnjë interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*vendimi nr. 42, datë 29.9.2011 i Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata në jurisprudencën e saj ka thënë se e drejta e ankimit, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, duhet kuptuar si mundësi e çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar, në një gjykatë më të lartë, vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët. Sipas Kushtetutës, kujtdo i garantohet e drejta për t'u ankuar, të paktën një herë, kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është një tejkallim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim KEDNJ-ja (*shih vendimin nr. 42, datë 29.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit për mospranimin e ankimit të kërkuesit për shkak të moslegjitimitetit të tij, është marrë si rrjedhojë e një procesi jo të rregullt dhe vjen ndesh me parashikimet e nenit 450, paragrafi "ç", të Kodit të Procedurës Civile.

12. Nga aktet gjyqësore rezultojnë që ankimi i depozituar pranë Gjykatës së Apelit nga ana e kërkuesit, është nënshkruar nga avokati i papajisur me prokurë. Referuar procesverbaleve gjyqësore, Gjykata vëren se pavarësisht kësaj të metë nga ana procedurale, Gjykata e Apelit ka zhvilluar gjykimin, duke legjitimuar dhe dëgjuar palët në lidhje me pretendimet e tyre, madje duke administruar edhe pretendimet përfundimtare, të cilat janë paraqitur me shkrim në seancën gjyqësore të datës 14.6.2010, gjë që vërtetohet në procesverbalin gjyqësor të kësaj date. Për më tepër, siç rezultojnë nga procesverbali i datës 11.5.2010, gjykimi është shtyrë për t'i dhënë mundësi avokatit A.R. për t'u njohur me materialet e dosjes.

13. Gjykata vëren se, edhe pse Gjykata e Apelit ka orientuar procesin në drejtim të shqyrtimit gjyqësor substantiv të çështjes, duke u dhënë mundësi palëve të realizojnë mbrojtjen e tyre në respekt të barazisë së armëve dhe parimit të kontradiktoritetit, vendimmarrjen e saj e ka bazuar në moslegjitimitimin e kërkuesit, duke u kufizuar në vlerësimin nga ana formale të ankimit dhe pa shqyrtuar çështjen në themel.

14. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit duhet të arsyetonte në mënyrë ezauruese mospranimin e ankimit, duke shpjeguar nëse ky i fundit është bërë nga një person që nuk legjitimohej, apo nuk është bërë në formën e kërkuar nga ligji për shkak të mungesës së nënshkrimit nga vetë pala apo avokati i papajisur me prokurë.

15. Në këtë kuptim, referuar paragrafit “b” të nenit 455¹ të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata e Apelit ka pasur detyrimin ligjor për të njoftuar palën që të ndreqte të metat brenda 5 ditëve, dhe vetëm në rast të mosplotësimit të këtij detyrimi mund të kthente ankimin në bazë të kësaj dispozite. Nga materialet e dosjes gjyqësore, rezulton se kjo kërkesë ligjore, e cila garanton realisht të drejtën e individit për t’iu drejtuar Gjykatës së Apelit, nuk është përmbushur. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme dhe bazuar në faktet e parashtruara, Gjykata çmon se Gjykata e Apelit ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt në vendimmarrje, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën e kërkuarit për akses efektiv përpara gjykatës, e për rrjedhojë vendimi duhet të shfuqizohet.

16. Gjykata, ka arritur në përfundimin se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t’i cenohen kërkuarit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimin nr. 22, datë 26.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Trajtimi i mjetit procedural në mënyrë josubstanciale cenon të drejtën e mbrojtjes dhe njëkohësisht aksesin në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 24.7.2006*).

18. Gjykata, në frymën edhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së, është shprehur se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion dhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (*shih vendimin nr 5, datë 2.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Kërkuari ka pretenduar, gjithashtu, se Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, pasi nuk ka pranuar rekursin dhe nuk ka shqyrtuar pretendimet, edhe pse ato kishin të bënin me shkeljet ligjore dhe mosrespektimin e normave procedurale.

20. Gjykata ka theksuar se gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Gjykata ka pranuar cenimin e parimit për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës Civile, nuk ka plotësuar apo nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 5, datë 25.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se shkelja e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e Gjykatës së Apelit Durrës, nuk është plotësuar ose korrigjuar nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

22. Në këto kushte, arrihet në përfundimin se edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka lejuar një proces të parregullt në aspektin kushtetues dhe, për pasojë, vendimi duhet të shfuqizohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr. 142, datë 31.1.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 260, datë 14.6.2010 të Gjykatës së Apelit Durrës.

¹ b) Në rast se ankimi nuk plotëson kushtet e mësipërme, si dhe ato të neneve 453 dhe 454 të këtij Kodi, gjykata njofton palën që të ndreqë të metat brenda 5 ditëve, në të kundërt ankimi kthehet.



- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Durrës.
Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë, dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Vendosur në datën 26.9.2013

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 849, datë 23.12.2013

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE NË QARKUN FIER, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 23.12.2013, me pjesëmarrjen e:

Lefterije Luzi (Lleshi)	kryetare
Hysen Osmanaj	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, në qarkun e Fierit, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, për shkak të humbjes së jetës të deputetit z. Sokol Olldashi.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 7361 prot., datë 18.12.2012, drejtuar KQZ-së, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të humbjes së jetës të deputetit z. Sokol Olldashi, deputet i zonës zgjedhore qarku Fier.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës, dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit vijues të listës shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 29, datë 2.8.2013, ka vendosur “Shpërndarjen e mandateve brenda koalicioneve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zonën zgjedhore qarku Fier, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013”. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Demokratike për zonën zgjedhore qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013, ka fituar 4 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Demokratike për qarkun e Fierit, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Sokol Olldashi, me numër rendor 2 (dy) Mesila Doda, me numër rendor 3 (tre) Kozma Dashi, me numër rendor 4 (katër) Shpëtim Idrizi.

Me njoftimin për krijimin e vakancës, për shkak të humbjes së jetës të deputetit z. Sokol Olldashi, KQZ-ja ka detyrimin ligjor të marrë vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën e kandidatëve të listës shumemërore të Partisë Demokratike, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Rezultoni se lista shumemërore e Partisë Demokratike, në qarkun Fier, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja, me vendimin nr. 340, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Demokratike, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për punësim, mirëqenie dhe integritet”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike për 12 zonat zgjedhore. Sipas vendimit të mësipërm, lista shumemërore e Partisë Demokratike për qarkun Fier, e miratuar nga KQZ-ja, ka këtë renditje: me numër rendor 1 (një) Sokol Olldashi, me numër rendor 2 (dy) Mesila Doda, me numër rendor 3 (tre) Kozma Dashi, me numër rendor 4 (katër) Shpëtim Idrizi.

Sipas listës shumemërore të Partisë Demokratike për qarkun Fier, kandidati, i cili renditet me numër rendor 5 (pesë), është zoti Bedri Veli Mihaj. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm, rezultoni se, personit të cilit do t’i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumemërore, për të plotësuar vendin vakant të krijuar, për shkak të humbjes së jetës të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Sokol Olldashi, është z. Bedri Veli Mihaj, i cili është kandidati vijues i radhës, i renditur përkatësisht me numër rendor 5 (pesë).

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164 të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Fier, z. Bedri Veli Mihaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 16 lekë